



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Përkthim (A-B) (2)

Ngarkesa: 3 kredite, 30 seminare

Viti / Semestri: Viti I, *semestri* II

Lloji i lëndës: *e detyrueshme*

Programi i studimit: Master Shkencor në ‘‘Përkthim Teknik-Letrar dhe Interpretim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T’u sigurojë studentëve njohuritë thelbësore mbi terminologjinë e përdorur në fushat e politikës, ligjit, drejtësisë dhe disiplinave të tjera gjatë procesit të përkthimit nga shqipja në anglisht. Të zhvillojë aftësitë praktike të përdorimit të mjetëve të ndihmës si glosarë, fjalorë dhe platforma kompjuterike në përkthim. Të ndërtojë lidhje organike ndërmjet teorisë dhe praktikës në përkthimin e teksteve teknike dhe funksionale, duke përfshirë përdorimin e platformës TRADOS dhe MULTITERM.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të trajtojë dukuritë gramatikore, leksikore dhe stilistike në varësi të natyrës dhe stilit të tekstit që përkthehet.
2. Të aftësojë studentët për të përdorur në mënyrë efikase platformën TRADOS dhe përditësimin e bazës së termave MULTITERM gjatë përkthimit.
3. Të zhvillojë aftësinë e analizës kritike dhe krahasimit të varianteve të përkthimeve të gjeneruara manualisht dhe atyre të krijuara nga softueri në kohë reale.

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Identifikojnë dhe përdorin terminologjinë e saktë në përkthimin e teksteve nga fusha të ndryshme specifike si politika, ligji dhe drejtësia.
2. Përdorin me aftësi mjetet dhe platformën TRADOS, duke menaxhuar bazën e termave MULTITERM në mënyrë autonome dhe efikase.
3. Analizojnë dhe krahasojnë rezultatet e përkthimit manual dhe të atij të asistuar nga kompjuteri për të siguruar cilësinë dhe koherencën e teksteve të përkthyer.